

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Lacaune Sheep Albania” SHPK.**

Sot, në Tiranë, më 16.02.2023, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak i vetëm themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“Lacaune Sheep Albania” SHPK.**

Unë ortaku Marko Mullai lindur më 23-09-1987, në Këlcyrë, Përmet dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga Zenel Baboçi, Nd.4, H.1, Njësia Administrative Nr.9, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin Nr. 037866672 dhe me numër personal I70923028F, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare **“Lacaune Sheep Albania” SHPK**, e cila do të nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare **“Lacaune Sheep Albania” SHPK** do të jetë në adresën: **Rruga Këlcyrë – Përmet, Zona Kadastrale 2131, Numri i Pasurisë 267/16, Këlcyrë, PËRMET.**

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit. Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: **Rritja dhe mbarështimi i dhenve, prodhim i qumështit dhe leshit të papërpunuar.**

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

**Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **40,000 (Dyzet mijë EUR)**, kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.



## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "Lacaune Sheep Albania" SHPK do të drejtohet nga **Administratori i saj Z.Marko Mullai** për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

### Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### Neni 10

Shoqëria tregtare "Lacaune Sheep Albania" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### Neni 11

Shoqëria tregtare "Lacaune Sheep Albania" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

## THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"Lacaune Sheep Albania" SHPK

ORTAKU I VETËM

MARKO MULLAI

